



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**

VENDIM

**PËR MIRATIMIN E LISTAVE SHUMEMËRORE TË KANDIDATËVE PËR ANËTARË NË
KËSHILLIN E BASHKIVE TË DEPOZITUARA NGA PARTIA BINDJA DEMOKRATIKE, PËR
ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË VITIT 2019**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e datës 22.05.2019, me pjesëmarrjen e:

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv.Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI-	Anëtare

Shqyrtoi çështjen me:

OBJEKT: Për miratimin e listave shumëmemërore të kandidatëve për anëtar në Këshillin e Bashkive: Tiranë, Kamëz, Korçë, Elbasan, Durrës, Shkodër, Fier, Lezhë, Vlorë, Lushnjë të paraqitura nga "Partia Bindja Demokratike", për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019.

BAZË LIGJORE: Neni 23, pika 1, germa "a", dhe neni 73, pika 1, të Ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga "Partia Bindja Demokratike", si dhe dëgjoi diskutimet e përfaqësuesve të partive politike,

V Ë R E N:

Partia Bindja Demokratike, me vendimin e KQZ-së nr. 230, datë 24.04.2019, është regjistruar si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të vitit 2019.

Në bazë të nenit 67, dhe nenit 72, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", ka depozituar në KQZ listën shumëmemërore të kandidatëve të saj për anëtar në Këshillin e Bashkive: Tiranë, Kamëz, Korçë, Elbasan, Durrës, Shkodër, Fier, Lezhë, Vlorë, Lushnjë.

Në bazë të nenit 67, pika 3, KQZ duhet të regjistrojë kandidatët për kryetar apo për këshillin e bashkive Tiranë, Kamëz, Korçë, Elbasan, Durrës, Shkodër, Fier, Lezhë, Vlorë, Lushnjë; pasi bashkitë Tiranë, Kamëz, Korçë, Elbasan, Durrës, Shkodër, Fier, Lezhë, Vlorë, Lushnjë, administrohen nga më shumë se një KZAZ.



Nr. 628 i Vendimit

Data 22.05.2019

Ora 17:00 e Vendimit

Për miratimin e listave shumëmemërore të kandidatëve për anëtar në Këshillin e Bashkive të paraqitura nga "Partia Bindja Demokratike", për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019

Bashkëlidhur kërkesës është depozituar dhe dokumentacioni përkatës, si më poshtë:

1. Listat shumemërore të kandidatëve për anëtar në Këshillin e Bashkive Tiranë, Kamëz, Korçë, Elbasan, Durrës, Shkodër, Fier, Lezhë, Vlorë, Lushnjë;
2. Deklaratat e kandidatëve të listave shumemërore, të cilët deklarojnë se gëzojnë të drejtën dhe vullnetin për të kandiduar për anëtar këshilli në Këshillin e Bashkive: Tiranë, Kamëz, Korçë, Elbasan, Durrës, Shkodër, Fier, Lezhë, Vlorë, Lushnjë të propozuar nga Partia e Bindja Demokratike;
3. Kopje të dokumentit të identifikimit për të gjithë kandidatët e listave shumemërore;
4. Vërtetim i Kuvendit të Shqipërisë, nr. 13 prot., datë 13.05.2019, sipas të cilit vërtetohet se Bindja Demokratike, përfaqësohet nga 2 deputetë në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë.
5. Jetëshkrimin për të gjithë kandidatët e listës shumemërore;
6. Formularin e vetëdeklarimit, në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike";
7. Procesverbal i dorëzimit të dokumentave të kandidimit.

Në mbledhjen e datës 22.05.2019 në bazë të nenit 73, të Kodit Zgjedhor, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve verifikoi listat shumemërore të kandidatëve për këshillin e Bashkive: Tiranë, Kamëz, Korçë, Elbasan, Durrës, Shkodër, Fier, Lezhë, Vlorë, Lushnjë të Partisë Bindja Demokratike dhe dokumentacionin bashkëngjitur të paraqitur dhe konstatoi se është në përputhje me kërkesat e parashikuara nga neni 67, pika 2, 4, 5 dhe 6 dhe neni 72 të Kodit Zgjedhor.

Në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", verifikoi të dhënat në formularët e vetëdeklarimit për secilin kandidat të listës shumemërore. Nga verifikimi i të dhënave në formularin e vetëdeklarimit, asnjëri prej tyre nuk ka deklaruar asnjë të dhënë që ka të bëjë me parashikimet për ndalime në ligjin nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes gjyqësore dhe zyra e gjendjes civile nëpërmjet shkresave si dhe nëpërmjet postës elektronike për kandidatët për anëtarë në këshillin bashkiak, që kanë dorëzuar formularët e vetëdeklarimit në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, për bashkinë Tiranë, Kamëz, Korçë, Durrës, Fier, Vlorë.

Zyra e gjendjes gjyqësore nuk ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e gjendjes gjyqësore për kandidatët për anëtarë në këshillat bashkiak, Bashkia Elbasan, Shkodër, Lezhë, Lushnjë. KQZ do të vazhdojë e procedurat të mëtejshme për verifikim.

Zyra e gjendjes gjyqësore ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e gjendjes gjyqësore për kandidatët për anëtarë në këshillat bashkiak Tiranë, Kamëz, Korçë, Durrës, Fier, Vlorë nga ku rezulton se:

Kandidati **z. Gjergji Lickollari**, Bashkia Korçë, në bazë të vendimit nr. 168, datë 16.03.2015 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, deklarohet fajtor për veprën penale "Vjedhje të energjisë elektrike ose impulseve telefonike", parashikuar nga neni 137/2 K.P dhe neni 406 K.Pr.P dënohet me 8 muaj burgim. Në aplikim të nenit 59 K.P vihet në shërbim prove për 2 vjet.

Kandidati **Anesti Trebicka**, Bashkia Korçë, në bazë të vendimit nr. 59, datë 28.01.2013 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë është deklaruar fajtor për veprën penale "Mbajtje pa leje të armëve të ftohta", e në bazë të nenit 279, 51 K.P dhe neni 406 K.Pr.P dënohet me 2 muaj burgim. Në zbatim të nenit 63 K.P urdhërohet pezullimi i ekzekutimit të dënimit me burgim dhe zëvendësimin e tij me detyrimin e kryerjes të një pune me interes publik prej 60 ore punë. Rehabilituar në bazë të nenit 69 K.Penal.

Kandidati **z. Helius Kabili** Bashkia Kamëz, në bazë të vendimit nr. 2545 datë 03.10.2018 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë është deklaruar fajtor për veprën penale "Përvetësim i



parave e mallrave që rrjedhin nga vepra penale ose veprimtaria kriminale”, parashikuar nga neni 287/n-25 K.P dhe neni 406 K.Pr.P denuar me 4 muaj burgim. Në aplikim të Nenit 59 të K.P urdhërohet pezullimi i ekzekutimit të vendimit të dënimit me burgim dhe venia në provë për një periudhë prej 8 muaj me kusht.

Kandidati **z. Xhevat Rama** Bashkia Kamëz, në bazë të vendimit nr.1160 datë 14.04.2015 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë është deklaruar fajtor për veprën penale “Vjedhjes së energjisë elektrike ose impulsive telefonike” parashikuar nga neni 137/1 I K.P dhe neni 406 K.Pr.P denohet me 8 muaj burgim. Në zbatim të Nenit 59 të K.P pezullohet ekzekutimi i dënimit me burgim për një afat kohe prej 18 muajsh.

Kandidati **z. Artion Muja** Bashkia Kamëz, në bazë të vendimit nr. 307 datë 24.07.2008 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër është deklaruar fajtor për veprën penale “Vjedhjes” parashikuar nga neni 134/2, 22, 51 K.P dhe neni 406 K.Pr.P dënohet me 1 muaj burgim. Gjykata e Apelit Shkodër me vendimin nr. 284 datë 28.10.2008 ka vendosur lënien në fuqi të vendimit.

Në bazë të nenit 69 K.P rehabilitohet.

Kandidati **z. Fali (Fatmir) Cani** Bashkia Kamëz, në bazë të vendimit nr. 1771 datë 25.05.2015 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë është deklaruar fajtor për veprën penale “Vjedhjes së energjisë elektrike ose impulsive telefonike”. Në bazë të nenit 134/1 K.P dhe 406 të K.Pr.P dënohet me 4 muaj burgim. Në aplikim të nenit 59 K.P pezullohet ekzekutimi I dënimit me burgim dhe vihet në provë për 18 muaj.

Në bazë të nenit 69 K.P rehabilitohet.

Kandidati **z. Qerim Xhimo** Bashkia Durrës, në bazë të vendimit nr. 611 datë 16.06.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës është deklaruar fajtor për veprën penale “Vjedhjes” parashikuar nga neni 134/2, 51, 49 K.P dënohet me 1 muaj burgim. Në aplikim të nenit 59 K.P vihet në provë për një periudhë prej 18 muaj.

Në bazë të nenit 69 K.P rehabilitohet.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, referuar pikës 2, paragrafi i fundit, të kreut V të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit, konstaton se për personat e shënuar në listën shumemërore të dhënat e tyre nuk përbëjnë kusht për mosregjistrimin si kandidatit për këshillin e bashkisë, sipas ligjit nr. 138/2015.

KQZ gjithashtu ka bërë publikimin e formularëve të vetëdeklarimit në faqen zyrtare të internetit.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, bazuar në nenin 73, pika 1, të Kodit Zgjedhor, në mbledhjen e datës 22.05.2015, verifikoi listat shumemërore të kandidatëve për anëtar në Këshillin e Bashkive: Tiranë, Kamëz, Korçë, Elbasan, Durrës, Shkodër, Fier, Lezhë, Vlorë, Lushnjë dhe dokumentacionin bashkëngjitur, të depozituar nga “Partia Bindja Demokratike” dhe konstatoi se ishte në përputhje me kërkesat e parashikuara në nenin 67, pikat 2, 4, 5, dhe 6, nenin 72 të Kodit Zgjedhor.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve mbështetur në nenin 23, pika 1, germa “a”, nenin 67, pikat 2, 4, 5, dhe 6, nenin 72, dhe nenin 73, pika 1, pika 2 të Ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.



V E N D O S I:

1. Miratimin e listave shumemërore të kandidatëve për anëtarë të Këshillin e Bashkive: Tiranë, Kamëz, Korçë, Elbasan, Durrës, Shkodër, Fier, Lezhë, Vlorë, Lushnjë të Partisë "Bindja Demokratike", në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019, sipas lidhjes nr. 1, bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 5 ditëve nga shpallja e tij.

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv.Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI-	Anëtare

